



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 406/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e operatorit ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-09523-02-20-2019, me objekt: “*Ndërtim rruga Skënderbeu+Shebeniku*”, me fond limit 59.286.710 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 02.04.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz. Gjithashtu ngrihen pretendime për operatorët ekonomikë “Arb&Trans-2010” sh.p.k, “Kthella” sh.p.k dhe “Liqeni VII” sh.p.k.”

Ankimues: Operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k.
Lagjia “Babrru-Fushë”, Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz.
“Bulevardi Blu”, nr.492, Kamëz – Tiranë

Subjekte të Interesuar: “Alb & Trans-2010” sh.p.k
Cekrezë-Morinë, Nd.2 katëshe, 100 m larg ish stallave, Zallherr, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 26.02.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-09523-02-20-2019, me objekt: “*Ndërtim rruga Skënderbeu+Shebeniku*”, me fond limit 59.286.710 lekë pa tvsh, zhvilluar ne datën 02.04.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.

II.2. Referuar dokumentacionit të operatorëve ekonomikë të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, si edhe raportit të auditit në sistemin e prokurimeve elektronike, në këtë procedurë

prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1.	“Company Riviera 2008” sh.p.k	46.016.665,00 lekë, skualifikuar
2.	“SMO Union” sh.p.k	46.435.394,00 lekë, skualifikuar
3.	“B-93” sh.p.k	48.648.672,00 lekë, skualifikuar
4.	“AL-Asfalt” sh.p.k	49.088.775,00 lekë, skualifikuar
5.	“Curri” sh.p.k	49.955.611,00 lekë, skualifikuar
6.	“Pepa Group Group” sh.p.k	52.311.215,00 lekë, skualifikuar
7.	“Leon Konstruksion” sh.p.k	53.072.302,00 lekë, skualifikuar
8.	“Sireta 2F” sh.p.k.	53.999.999,00 lekë, skualifikuar
9.	“Alb & Trans-2010” sh.p.k	56.876.235,00 lekë, kualifikuar
10.	“Kthella” sh.p.k.	56.942.121,00 lekë, kualifikuar
11.	“Kupa” sh.p.k	58.342.370,00 lekë, skualifikuar
12.	“Be - Is” sh.p.k.	58.357.316,00 lekë, kualifikuar
13.	“Liqeni VII” sh.a.	59.286.710,00 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 30.04.2019 operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me arsyet si më poshtë vijon:

1. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori Roland Prenga.
2. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori Bledian Muça.
3. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Eshref Shahini.
4. I ka skaduar dëshmia e kualifikimi të sigurimit teknik Arben Moqi.
5. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Kujtim Sula.
6. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Altin Meta.
7. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Idriz Loga.
8. Shoferi Marildo Shkalla, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik si dhe nuk eshte ne listepagesa.
9. Drejtuesja Teknike Erjana Koltraka (Zuna) eshte vetem ne listepagesat e muajit shkurt 2019.
10. Inxhinieri elektrik Leonidha Rebi eshte 80 vjeç dhe ne CV-ne qe ka dorezuar shprehet se eshte i punesuar ne 10 kompani dhe nuk shprehet se eshte i punesuar ne kompanine Sireta 2F.
11. Mjeti AA391FB nuk ka te percaktuar kapacitetin ne lejen e qarkullimit si dhe nuk eshte paraqitur certificate pronesie.
12. Per asfaltoshtruesen me zinxhir, urdheri i çlirimit doganore eshte fotokopje + fatura tatimore e leshuar, nuk eshte leshuar nga subjekti importues.
13. Kontrata e shitjes per eskavatorin me zinxhir nuk eshte lidhur perpara noterit.
Per minieskavatorin nuk percaktohet ne urdher çlirimin doganore se shitesi eshte importuesi i eskavatorit si dhe nuk ka vertetim zhdoganimi.

II.4. Në datën 12.04.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në të cilën kundërshton skualifikimin e ofertës së tij. Gjithashtu ngrihen pretendime

për operatorët ekonomikë “Arb&Trans-2010” sh.p.k, “Kthella” sh.p.k dhe “Liqeni VII” sh.p.k.” Konkretisht pretendohet si vijon:

“ [...]

I. Lidhur me arsyen e skualifikimit për të cilat KVO pretendon se: “1. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori Roland Prenga. 2. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori Bledian Muça. 3. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Eshref Shahini. 4. I ka skaduar dëshmia e kualifikimi të sigurimit teknik Arben Moqi. 5. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Kujtim Sula. 6. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Altin Meta. 7. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Idriz Loga. 8. Shoferi Marildo Shkalla, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik si dhe nuk është në listepagesa.

Argumentojmë se: secili nga manovratorët dhe shoferët e paraqitur nga ana e shoqërisë sonë është i pajisur me Dëshminë e Aftësisë Profesionale nga institucionet kompetente, dokumenta këto të cilat janë paraqitur bashkëlidhur cdo punonjësi dhe konkretisht: Manovratori Roland Prenga; Manovratori Bledian Muça; Eshref Shahini; Arben Moqi; Kujtim Sula; Altin Meta; Idriz Loga, dhe duke qënë se secili nga këta punonjës e zotëron Dëshminë e Aftësisë profesionale, lëshuar nga organi kompetent administrativ, bazuar në legjislacionin në fuqi. Në përmbushje të kësaj pike shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin e punonjësve si më poshtë vijon:

- 1. Automakinist B.Koldashi*
- 2. Automakinist A.Ismailaj*
- 3. Automakinist S.Keputa*
- 4. Automakinist T.Loca*
- 5. Eskavatorist E.Loca*
- 6. Eskavatorist E.Koni*
- 7. Eskavatorist H.Kalaj*
- 8. Manovrator H.Morinaj*
- 9. Manovrator B.Muca*
- 10. Manovrator A.Moqi*
- 11. Manovrator R.Prenga*
- 12. Shofer A.Meta*
- 13. Shofer D.Dajti*
- 14. Shofer E.Shahini*
- 15. Shofer I.Loga*
- 16. Shofer J.Koldashi*
- 17. Shofer K.Sula*
- 18. Shofer M.Shkalla*

Autoriteti kontraktor ka kërkuar 3(tre) punonjës manovrator/eskavatorist dhe në plotësim të kësaj pike ne si shoqëri kemi paraqitur dokumentacionin e plotë të tre eskavatoristëve sic janë:

- 1. Eskavatorist E.Loca*
- 2. Eskavatorist E.Koni*
- 3. Eskavatorist H.Kalaj, eskavatoristë të cilët janë të pajisur edhe me ISHTI, ashtu sic i ka kërkuar edhe autoriteti kontraktor në DST.*

Autoriteti kontraktor ka kërkuar 3 punonjës shofer mjete të rënda, dhe në plotësim të këtij kriteri mund është paraqitur dokumentacioni i plotë, gjithashtu dhe me pajisjen e tyre me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, punonjësit si:

1. Automakinist B.Koldashi
2. Automakinist A.Ismailaj
3. Automakinist S.Keputa,

pra sërish shoqëria jonë ndodhet në kushtet ku i përmbush plotësisht kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor.

Në vijim autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit tek kriteret e vecanta të kualifikimit/kapaciteti teknik, në pikën 2.3, pika 8 ka kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këta punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”, pra referuar kësaj kërkesë të autoritetit kontraktor me këta punonjës, 4 punonjës manovrator të mjeteve të rënda nuk kërkohet pajisja e këtyre punonjësve me ISHTI, pra në plotësim të kësaj kërkesë nga ana jonë janë paraqitur punonjësit:

1. R.Prenga
2. B.Muca
3. A.Moqi
4. T.Loca

Pra sa më sipër rezulton se kërkesa e dhënë nga ana juaj plotësohet tërësisht.

Sa më sipër, në përmbushje të kriterëve të vecanta të kualifikimit/kapaciteti teknik, në pikën 2.3 pika 7 dhe 8, shoqëria jona ka paraqitur në total 17 punonjës me dokumentacion të plotë të kërkuar nga ana juaj për pozicionet 3 manovrator/eskavatorist, 3 punonjës shofer mjete të rënda dhe 4 punonjës manovrator të mjeteve të rënda, këta të fundit në përmbushje të pikës 8.

II. Lidhur me arsyet e skualifikimit për të cilat KVO pretendon se: “Drejtuesja Teknike E.Koltraka (Zuna) është vetëm në listepagesat e muajit shkurt 2019. Inxhinieri elektrik Leonidha Rebi është 80 vjeç dhe në CV-ne që ka dorëzuar shprehet se është i punësuar në 10 kompani dhe nuk shprehet se është i punësuar në kompaninë Sireta 2F”.

Autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kapaciteti teknik, pika 5 ka kërkuar: “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1(një) inxhinier Elektrik

1. Për përmbushjen e këtij kriteri shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin e dy inxhinierëve elektrikë: inxhinierja Erjana Koltraka (Zuna) dhe inxhinieri elektrik Leonidha Rebi. Nga ana e KVO-së është përmendur si kusht skualifikimi fakti që drejtuesja teknike Erjana Koltraka (Zuna) rezulton në listpagesa vetëm për muajin shkurt 2019. Ky nuk mund të jetë kusht skualifikimi, pasi do të detyrohem të për të disajtën herë t’ju mësojmë rregullat elementare mbi disponimin dhe pajisjen me licencat profesionale në fushën e ndërtimit. Kështu VKM-ja nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”,

përcakton që drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar në subject nga momenti që nënshkruajnë kontratën punës dhe bëhen pjesë e licencës së shoqërisë së ndërtimit. Licenca jonë është lëshuar në datën 05.03.2019, dhe nga kjo datë drejtuesit teknikë të saj rezultojnë të gjithë të siguruar sipas detyrimeve ligjore.

2. Por në përmbushje të kriterit të dhënë nga ana juaj, ne kemi të punësuar dhe është paraqitur dokumentacion për një tjetër inxhinier elektrik, z.Leonidha Rebi. Është qesharake arsyeja e pretenduar nga KVO-ja që ky zotëri është 80 vjec në CV-në që ka dorëzuar shprehet se është i punësuar në 10 kompani dhe nuk shprehet se është i punësuar në kompaninë Sireta 2F. Lidhur me këtë pretendim të KVO-së theksojmë që nuk është CV-ja ajo që përcakton punësimin e punëmarrësit në kompaninë tonë, por është kontrata e punës, librezja e punës si dhe listpagesat e shoqërisë, ndërsa CV-ja është një dokument i cili vërteton eksperiencën e punës.

Kompania jonë në veprimtarinë e saj nuk bazohet mbi hamëndje, por mbi kushtet ligjore të punësimit, për të cilin ka paraqitur diplomë, librezë pune dhe ka paguar pagesën përkatëse, sipas listpagesave të konfirmuara të shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit stafi inxhinierik. Nuk arrijmë të kuptojmë se si shpikni arsye me qëllimin e vetëm skualifikimin e shoqërisë sonë dhe pse në mënyrë kryekëput të paligjshme.

III. Lidhur me arsyen e skualifikimit për të cilat KVO pretendon se mjeti AA391FB nuk ka të përcaktuar kapacitetin në lejen e qarkullimit si dhe nuk është paraqitur certifikatë pronësie.

Për asfaltoshtuesen me zinxhir, urdhëri i clirimit doganor është fotokopje + fatura tatimore e lëshuar nuk është lëshuar nga subjekti importues.

Kontrata e shitjes për eskavatorin me zinxhir nuk është lidhur përpara noterit.

Për minieskavatorin nuk përcaktohet në urdhër clirimin doganor se shitësi është importuesi i eskavatorit si dhe nuk ka vërtetim zhdoganimi.

Autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit tek kriteret e vecanta të kualifikimit /kapaciteti teknik, pika 2.3 pika 11 ka kërkuar dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçina me kapacitet mbajtës 2 -5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autokulle per montimin e ndricuesve	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul me vibrim për ngjeshjen e nenshtresave mbi 12 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues për ngjeshje asfalti mbi 7.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues për ngjeshje asfalti mbi 2.5ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera

Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkator	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 35 (tridhjetë e pese) copë;
 - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 4 katër) copë;
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 (tre) copë;
 - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 (katër) copë;
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pesë) copë.
- a)** *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshmëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç ’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- b)** *Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).*
- c)** *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d)** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e)** *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f)** *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamez. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*

Mjetet e paraqitura nga shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k janë të shoqëruara me të gjithë dokumentacionin e kërkuar si: a)dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, b) leje qarkullimi;c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qira janë paraqitur: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin

e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet janë të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë / furnizimit, të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera janë paraqitur aktet e cdoganimit ose fatura tatimore të blerjes, sic është kërkuar nga ana juaj në tenderin që është prokuruar nga Bashkia Kamëz. Kemi bindjen se janë të pakët operatorët ekonomikë që zotërojnë një dokumentacion të plotë dhe kaq të saktë sic i disponon shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k.

1. Përsa i përket pretendimit: Mjeti AA391FB nuk ka të përcaktuar kapacitetin në lejen e qarkullimit si dhe nuk është paraqitur certifikatë pronësie sqarojmë se: Mjeti me targa AA 391 FB e cila është koka tërheqëse dhe duke u bazuar në kodin rrugor koka tërheqëse nuk mund të ketë peshë bruto të përcaktuar, pasi koka tërheqëse ka në përbërje dhe dy element të tjerë, mjetet e tjera me targë ABR 621, i cili është kazani dhe mjeti tjetër rimorkio me targë ACR237, i cili ka të bashkëlidhur gjithë dokumentacionin e plotë të kërkuar nga autoriteti juaj, si dhe lejen e qarkullimit, me të gjithë elementët e saj. Pra koka tërheqëse tërheq pesha të ndryshme duke qënë se ka në përbërje të vet edhe mjetet e tjera me targë ABR 621 dhe ACR237.
2. Përsa i përket pretendimit se: “Për asfaltoshtruesen me zinxhir, urdhëri i clirimit doganor është fotokopje + fatura tatimore e lëshuar, nuk është lëshuar nga subjekti importues, sqarojmë se në përmbushje të këtij kriteri nga ana jonë nuk është paraqitur një, por dy copë mjete asfaltoshtruese. Fatura tatimore është kontratë fakti që vërteton kalimin e pronësisë së sendit, pavarësisht kush ka bërë cdoganimin. Edhe në rastin më të keq, të keqkuptimit dhe keqzbatimit të ligjit nga ana juaj, sërish shoqëria jonë është në përmbushje të këtij kriteri pasi sic e thamë më sipër, kemi paraqitur edhe asfaltoshtruesen tjetër më shumë.
3. Përsa i përket pretendimit se: Kontrata e shitjes për eskavatorin me zinxhir nuk është lidhur përpara noterit sqarojmë se në përmbushje të këtij kriteri nga ana jonë nuk janë paraqitur dy, por tri copë mjete eskavatorë. Referuar dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar në këtë procedurë tenderimi 2 eskavatorë me zinxhir, dhe ndërkohë KVO pretendon se një nga eskavatorët e paraqitur nga shoqëria jonë, kontratën e shitjes së eskavatorit nuk e ka të nënshkruar para noterit. Por për plotësimin e këtij kriteri shoqëria jonë ka paraqitur tre eskavatorë dhe konkretisht Eskavatorin Liheberr R904 për të cilin KVO e paraqet si arsye për skualifikim, eskavatorin Ssmitoma S160 U- ë ME NR. Shasie 160 FU-5697 dhe Eskavatorin Volvo Telaio me nr. Shasie C012770. Edhe në rastin më të keq të keqzbatimit të ligjit nga ana juaj, sërish shoqëria jonë është në përmbushje të këtij kriteri pasi, sic argumentuam më sipër, kemi paraqitur edhe eskavator tjetër më shumë.
4. Përsa i përket pretendimit se: minieskavatorin nuk përcaktohet në urdhër clirimin doganor se shitësi është importuesi i eskavatorit si dhe nuk ka vërtetim zhdoganimi. Nga ana jonë është paraqitur kontrata e blerjes, fatura tatimore dhe cdo dokument shoqëruar sic është kërkuar në DST. Disponimin e mjetit nga ana e shitësit e ka vërtetuar noteri, bazuar në legjislacionin në fuqi, për të cilën ka përpiluar dhe kontratën përkatëse. [...].

Kërkojmë verifikimin dhe skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Arb & Trans 0 10” sh.p.k, “Kthella” sh.p.k dhe “Liqeni VII” sh.p.k pasi nuk plotësojnë kriterin “greider” në pronësi ose me qira , 1 copë.

II.5. Me shkresën nr. 2386/4 prot., datë 06.05.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën. Ankimuesi pretendon se me shkresën e autoritetit kontraktor nr. 2386/4 prot., datë 06.05.2019, është njohur në datën 08.05.2019.

II.6. Në datën 14.05.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij dhe duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 27.05.2019, nëpërmjet shkresës me nr.2685/1 prot., datë 24.05.2019, me objekt: *“Kthim përgjigje”* është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik *“Sireta 2F”* sh.p.k.

Në informacionin e paraqitur autoriteti kontraktor argumenton se:

[...]

Pas hapjes së ofertave dhe kontrollit të dokumentacionit ka rezultuar se, operatori ekonomik “Sireta 2F” është skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë:

1. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori Roland Prenga; Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori Bledian Muça; Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Eshref Shahini; I ka skaduar dëshmia e kualifikimi të sigurimit teknik Arben Moqi; Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Kujtim Sula; Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Altin Meta; Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Idriz Loga; Shoferi Marildo Shkalla, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik si dhe nuk eshte ne listepagesa. Për një pjesë të punonjësve ka parqitur dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik dhe për të tjerët jo.

2. Drejtuesja Teknike Erjana Koltraka (Zuna) eshte vetem ne listepagesat e muajit shkurt 2019. Pretendimet nuk qëndrojnë pasi inxhinierët e kërkuar duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë 6 muajt e fundit dhe nuk mund të figurojë drejtuesja teknike vetëm një muaj në listpagesat e shoqërisë.

3. Inxhinieri elektrik Leonidha Rebi eshte 80 vjeç dhe ne CV-ne qe ka dorezuar shprehet se eshte i punesuar ne 10 kompani dhe nuk shprehet se eshte i punesuar ne kompanine Sireta 2F. Pretendimet tuaja bien ndesh me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe moshën e pensionit të përcaktuar me ligj. Inxhinieri elektrik është në moshën ku duhet të përfitonte moshën e pensionit të pleqërisë.

4. Mjeti AA391FB nuk ka te percaktuar kapacitetin ne lejen e qarkullimit si dhe nuk eshte paraqitur certificate pronesie. Për asfaltoshtruesen me zinxhir, urdhëri i clirimit doganor është fotokopje + fatura tatimore e lëshuar, nuk është lëshuar nga subjekti importues. Kontrata e shitjes për eskavatorin me zinxhir nuk është lidhur para noterit. Për minieskavatorin nuk përcaktohet në urdhër clirimin doganor se shitësi është importuesi i eskavatorit si dhe nuk ka vërtetim zhdoganimi.”

[...].

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k se: “Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori Roland Prenga. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori Bledian Muça. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Eshref Shahini. I ka skaduar dëshmia e kualifikimi të sigurimit teknik Arben Moqi. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Kujtim Sula. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Altin Meta. Ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Idriz Loga. Shoferi Marildo Shkalla, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik si dhe nuk është në listepagesa, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12, Kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 7, të dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë:

- 2 (dy) punonjës teknik ndërtimi
- 2 (dy) punonjës elektrikist
- 1 (nje) punonjës mekanik
- 2 (dy) punonjës hidraulik
- 3 (tre) punonjës Manovrator/Eskavatorist
- 3 (tre) punonjës shofer mjete te renda

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme; dëshmite e kualifikimit të sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

Ndërsa në pikën 8, po këtu, është parashikuar si vijon:

Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.

III.1.2. Operatori ekonomik ankimes në lidhje me këto arsye skualifikimi, argumenton se: “secili nga manovratorët dhe shoferët e paraqitur nga ana e shoqërisë sonë është i pajisur me Dëshminë

e Aftësisë Profesionale nga institucionet kompetente, dokumenta këto të cilat janë paraqitur bashkëlidhur cdo punonjësi dhe konkretisht: Manovratori Roland Prenga; Manovratori Bledian Muça; Eshref Shahini; Arben Moqi; Kujtim Sula; Altin Meta; Idriz Loga, dhe duke qënë se secili nga këta punonjës e zotëron Dëshminë e Aftësisë profesionale, lëshuar nga organi kompetent administrativ, bazuar në legjislacionin në fuqi. Në përmbushje të kësaj pike shoqëria jonë ka paraqitur dokumentacionin e punonjësve si më poshtë vijon: Automakinist B.Koldashi, Automakinist A.Ismailaj, Automakinist S.Keputa, Automakinist T.Loca, Eskavatorist E.Loca, Eskavatorist E.Koni, Eskavatorist H.Kalaj, Manovrator H.Morinaj, Manovrator B.Muca, Manovrator A.Moqi, Manovrator R.Prenga, Shofer A.Meta, Shofer D.Dajti, Shofer E.Shahini, Shofer I.Loga, Shofer J.Koldashi, Shofer K.Sula, Shofer M.Shkalla. Autoriteti kontraktor ka kërkuar 3(tre) punonjës manovrator/eskavatorist dhe në plotësim të kësaj pike ne si shoqëri kemi paraqitur dokumentacionin e plotë të tre eskavatoristëve sic janë:

1. Eskavatorist E.Loca
2. Eskavatorist E.Koni
3. Eskavatorist H.Kalaj,

eskavatoristë të cilët janë të pajisur edhe me ISHTI, ashtu sic i ka kërkuar edhe autoriteti kontraktor në DST. Autoriteti kontraktor ka kërkuar 3 punonjës shofer mjete të rënda, dhe në plotësim të këtij kriteri mund është paraqitur dokumentacioni i plotë, gjithashtu dhe me pajisjen e tyre me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, punonjësit si:

1. Automakinist B.Koldashi
2. Automakinist A.Ismailaj
3. Automakinist S.Keputa,

pra sërish shoqëria jonë ndodhet në kushtet ku i përmbush plotësisht kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor. Në vijim autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit tek kriteret e vecanta të kualifikimit/kapaciteti teknik , në pikën 2.3, pika 8 ka kërkuar: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për këta punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”, pra referuar kësaj kërkesë të autoritetit kontraktor me këta punonjës, 4 punonjës manovrator të mjeteve të rënda nuk kërkohet pajisja e këtyre punonjësve me ISHTI, pra në plotësim të kësaj kërkesë nga ana jonë janë paraqitur punonjësit:

1. R.Prenga
2. B.Muca
3. A.Moqi
4. T.Loca

Pra sa më sipër rezulton se kërkesa e dhënë nga ana juaj plotësohet tërësisht.

Sa më sipër, në përmbushje të kriterëve të vecanta të kualifikimit/kapaciteti teknik, në pikën 2.3 pika 7 dhe 8 , shoqëria jona ka paraqitur në total 17 punonjës me dokumentacion të plotë të kërkuar nga ana juaj për pozicionet 3 manovrator/eskavatorist, 3 punonjës shofer mjete të rënda dhe 4 punonjës manovrator të mjeteve të rënda, këta të fundit në përmbushje të pikës 8”.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në

procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 26, pika 8, gërma (b) të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.*

III.1.5. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k rezulton se për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor për 3 (tre) punonjës manovrator/eskavatorist, 3 (tre) punonjës shofer mjete te renda dhe minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda, përveç të tjerave, është paraqitur dokumentacioni si vijon:

1. Listpagesat e shoqërisë për periudhën dhjetor 2018 – shkurt 2019
2. Për 3 (tre) punonjës manovrator/eskavatorist është paraqitur:
 - Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe E.Loka në pozicionin eskavatorist, shoqëruar me Dëshminë e aftësisë profesionale, dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik, librezë pune, kartë identiteti
 - Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe H.Kalaj në pozicionin eskavatorist, shoqëruar me Dëshminë e aftësisë profesionale, dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik, kartë identiteti.
 - Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe E.Koni në pozicionin eskavatorist, shoqëruar me Dëshminë e aftësisë profesionale, dëshminë ekualifikimit të sigurimit teknik, librezë pune, kartë identiteti.
3. Për 3 (tre) punonjës shofer mjete te renda, rezulton se është dorëzuar:
 - Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe S.Keputa në pozicionin automakinist, shoqëruar me Dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik, librezë pune, kartë identiteti
 - Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe A.Islamaj në pozicionin shofer, manovrator, vincier, shoqëruar me leje drejtimi, Dëshminë e aftësisë profesionale për automakinist, librezë pune, kartë identiteti, Dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik

- *Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe B.Koldashi në pozicionin automakinist, shoqëruar me , librezë pune, kartë identiteti, Dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik.*
- 4. Për minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda është paraqitur:
 - *Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe R.Prengaj në pozicionin shofer manovrator, shoqëruar me leje manovrimi për automakinistë, librezë pune, kartë identiteti.*
 - *Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe B.Muca në pozicionin shofer/automakinist/manovrator, shoqëruar me Dëshminë e aftësisë profesionale, Leje drejtimi, kartë identiteti.*
 - *Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe T.Loca në pozicionin shofer, manovrator, vincier shoqëruar me Dëshminë e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë, Dëshminë e kualifikimit të sigurimit teknik, kartë identiteti, librezë pune.*
 - *Kontratë Pune ndërmjet Sireta 2F shpk dhe A.Moqi në pozicionin automakinist shoqëruar me leje manovrimi për automakinist, librezë pune, kartë identiteti, dëshmi kualifikimi.*

Nga verifikimet e bëra në listpagesat e periudhës dhjetor 2018-shkurt 2019 rezulton se punonjësit e mësipërm rezultojnë në këto listapagesa për periudhën e kërkuar nga AK.

III.1.6. Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përsa i përket pretendimit të autoritetit kontraktor se *ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori R. Prenga, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik manovratori B. Muça, i ka skaduar dëshmia e kualifikimi të sigurimit teknik A. Moqi*, rezulton se këta punonjës janë paraqitur në ofertën e shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor parashikuar në pikën 8 të Kapacitetit teknik në kriteret e vecanta të kualifikimit, për minimalisht 4 (kater) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda. Për ta kërkohej të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Në këtë kriter nuk është parashikuar kushti që duhet të paraqitet edhe dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik, gjë e cila nëse do të ishte kërkuar, do të përbënte detyrim për tu përmbushur nga ofertuesit.

Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet *2.Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për punonjësit *R. Prenga, B. Muça, A. Moqi*, pasi dokumentacioni i paraqitur është në përputhje me kushtet e paracaktuara në dokumentat e tenderit, dhe nenin 46 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdorin kriterë që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.1.7. Përsa i përket pretendimit të AK-së se *ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Eshref Shahini, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Kujtim Sula, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Altin Meta, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik Idriz Loga, shoferi Marildo Shkalla, ska dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik si dhe nuk është në listepagesa*, rezulton se këta punonjës janë paraqitur në tejkallim të kriterëve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, duke mos përbërë arsye skualifikimi, pasi kërkesat e AK plotësohen nëpërmjet punonjësve të cituar si më sipër në pikën III.1.5. të arsyetimit.

Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me arsyen e skualifikimit të shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k me argumentin se: *“Drejtuesja Teknike Erjana Koltraka (Zuna) është vetëm në listepagesat e muajit shkurt 2019”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik”, pika 3, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar kriteri si më poshtë:

Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune (përkatëse)*
- b) Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)*
- c) Diplomë*

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se “Sireta 2F” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër, përsa i përket Drejtuesit Teknik E.Koltrana (Zuna), ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Deklaratë nga shoqëri “Sireta 2F” sh.p.k sipas të cilës deklarohej nën përgjegjësinë e plotë se: *“I pranishëm me kohë të plotë për realizimin e plotë të punimeve për procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim rruga Shebeniku-Skënderbeu Laknas” do të jenë Drejtues Teknik Inxh.K.Duka dhe Inxh.E.Koltrana (Zuna)”*. Gjithashtu deklarojmë që inxhinierët e sipërcituar

nuk janë të okupuar në ndonjë objekt (punë) dhe do të jenë të pranishëm në objekt deri në përfundim të plotë të kontratës... ”.

2. Licenca e shoqërisë “Sireta 2F: sh.p.k ku figurojnë K.Duka dhe E. Zuna
3. Kontratë pune ndërmjet “Sireta 2F” shpk dhe E.Koltrana (Zuna) në pozicionin Drejtues Teknik, e lidhur në datë 18.02.2019, për një periudhë 5 vjecare.
4. Diplomë Bachelor në Inxhinieri Elektrike nga Universiteti Politeknik i Tiranës për E.Zuna
5. Diplomë Master i Shkencave në Inxhinieri Elektrike nga Universiteti Politeknik i Tiranës për E.Zuna.
6. Kartë identiteti
7. Librezë pune

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.2.4. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

III.2.5. Referuar sa më sipër, KPP konstaton se në kërkesat kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me dokumentacion provues se disponojnë Drejtues Teknik për ndjekjen e punimeve. Në kriterin e vecantë të kualifikimit, kapaciteti teknik nuk rezulton të jetë kërkuar që drejtuesi teknik i punimeve të figurojë në listpagesat e shoqërisë.

Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2.*Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për drejtuesin teknik, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij është në përputhje me kushtet e paracaktuara në dokumentat e tenderit, dhe nenin 46 të LPP-së. Fakti i konstatuar nga KVO-ja se *Drejtuesja Teknike Erjana Koltraka (Zuna) është vetëm në listepagesat e muajit shkurt 2019*, nuk përbën arsye skualifikimi pasi nuk është parashikuar në dokumentat e tenderit që drejtuesi teknik duhet të figurojë në listpagesa.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoritet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdorin kriterë që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.3. Lidhur me arsyen e skualifikimit të shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k me argumentin se: *“Inxhinieri elektrik L. Rebi është 80 vjeç dhe në CV-ne që ka dorëzuar shprehet se është i punësuar në 10 kompani dhe nuk shprehet se është i punësuar në kompaninë Sireta 2F.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti Teknik”, pika 5, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar kriteri si më poshtë:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 2(një) inxhinierë Ndërtimi
- 1(një) inxhinier Elektrik
- 1(një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshaidër/Gjeomatik.
- 1(një) inxhinier Hidroteknik
- 1(një) inxhinier Mekanik

III.3.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se “Sireta 2F” shpk në përmbushje të kriterit për inxhinier elektrik, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Listpagesat e shoqërisë
2. Kontratë pune ndërmjet “Sireta 2F” shpk dhe L.Rebi në pozicionin Inxh.Elektrik, e lidhur në datë 15.10.2015, për një periudhë 5 vjecare.
3. Diplomë në Inxhinieri Elektrike nga Universiteti Shtetëror i Tiranës për L.Rebi
4. Librezë pune për L.Rebi
5. CV për L.Rebi
6. Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik për L.Rebi

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.3.4. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.3.5. Referuar sa më sipër, KPP konstaton se në kriteret kualifikuese autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me dokumentacion provues se disponojnë inxhinier elektrik. KPP gjykon se shoqëria “Sireta 2F” SH.P.K e ka përmbushur kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit, duke paraqitur dokumentacion provues për inxhinierin elektrik me iniciale L.R dhe konkretisht rezulton se është paraqitur kontrata e punës e vlefshme, diploma përkatëse, librezë e punës, si dhe z. L.Rebi rezulton të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit. Arsyeja e skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor me pretendimin se *Inxhinieri elektrik L. Rebi është 80 vjeç dhe ne CV-ne qe ka dorezuar shprehet se është i punësuar ne 10 kompani dhe nuk shprehet se është i punësuar ne kompanine Sireta 2F*, bie në kundërshtim me nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi është kriter i pakërkuar në dokumentet e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson se, autoritetet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentet konkrete që duhet të

paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdorin kriterë që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor për inxhinier elektrik, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij është në përputhje me kushtet e paracaktuara në dokumentat e tenderit, dhe nenin 46 të LPP-së.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues se “Mjeti AA391FB nuk ka të përcaktuar kapacitetin në lejen e qarkullimit si dhe nuk është paraqitur certificate pronësie. Per asfaltoshtuesen me zinxhir, urdheri i çlirimit doganorë është fotokopje + fatura tatimore e leshuar, nuk është leshuar nga subjekti importues. Kontrata e shitjes për eskavatorin me zinxhir nuk është lidhur përpara noterit. Per minieskavatorin nuk përcaktohet në urdher çlirimit doganorë se shitesi është importuesi i eskavatorit si dhe nuk ka vertetim zhdoganimi, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 10, pjesë e dokumentave të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i deklaratës nga ana e operatorëve ekonomikë si më poshtë vijon:

Shtojca 10

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]
MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik:_____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt:_____

<i>Në pronësi</i>				
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa</i>	<i>Nr. Lejes qarkullimit</i>	<i>Nr. Shasisë</i>	<i>Të tjera</i>
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

<i>Me qera</i>					
<i>Lloji i Mjetit</i>	<i>Targa e mjetit</i>	<i>Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit</i>	<i>Nr. Shasisë së mjetit</i>	<i>Nr. Kont së qerasë (noterisë)</i>	<i>Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)</i>
1					
2					
3					
4					

5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

III.4.2. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12, Kriteret e vecanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik, pika 1, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar plotësimi I kushteve si më poshtë:

1. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10).

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtës 5 – 10 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçina me kapacitet mbajtës 2 -5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Autokulle per montimin e ndricuesve	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul me vibrim për ngjeshjen e nenshtresave mbi 12 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues për ngjeshje asfalti mbi 7.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues për ngjeshje asfalti mbi 2.5ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatriçe	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Rimorkator	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 35 (tridhjetë e pese) copë;
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 4 katër) copë;
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 3 (tre) copë;
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 4 (katër) copë;
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 (pesë) copë.

g) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik;

d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- h)** Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).
- i)** Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- j)** Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- k)** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- l)** Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamez. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

III.4.3 Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.4.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.4.5. Në nenin 26, pika 8, gërma “c”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.4.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.4.8. Lidhur me arsyet e mesiperme të skualifikimit, operatori ekonomik ankimues pretendon se:

“Mjetet e paraqitura nga shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k janë të shoqëruara me të gjithë dokumentacionin e kërkuar si: a)dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, b) leje qarkullimi;c) certifikatë e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qira janë paraqitur: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Mjetet janë të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë / furnizimit, të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera janë paraqitur aktet e cdoganimit ose fatura tatimore të blerjes, sic është kërkuar nga ana juaj në tenderin që është prokuruar nga Bashkia Kamëz. Kemi bindjen se janë të pakët operatorët ekonomikë që zotërojnë një dokumentacion të plotë dhe kaq të saktë sic i disponon shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k.

1.Përsa i përket pretendimit: Mjeti AA391FB nuk ka të përcaktuar kapacitetin në lejen e qarkullimit si dhe nuk është paraqitur certifikatë pronësie sqarojmë se: Mjeti me targa AA 391 FB e cila është koka tërheqëse dhe duke u bazuar në kodin rrugor koka tërheqëse nuk mund të ketë peshë bruto të përcaktuar, pasi koka tërheqëse ka në përbërje dhe dy element të tjerë, mjetet e tjera me targë ABR 621, i cili është kazani dhe mjeti tjetër rimorkio me targë ACR237, i cili ka të bashkëlidhur gjithë dokumentacionin e plotë të kërkuar nga autoriteti juaj, si dhe lejen e qarkullimit, me të gjithë elementët e saj. Pra koka tërheqëse tërheq pesha të ndryshme duke qënë se ka në përbërje të vet edhe mjetet e tjera me targë ABR 621 dhe ACR237.

2.Përsa i përket pretendimit se: *“Për asfaltoshtruesen me zinxhir, urdhëri i clirimit doganor është fotokopje + fatura tatimore e lëshuar, nuk është lëshuar nga subjekti importues, sqarojmë se në përmbushje të këtij kriteri nga ana jonë nuk është paraqitur një, por dy copë mjete*

asfaltoshtruese. Fatura tatimore është kontratë fakti që vërteton kalimin e pronësisë së sendit, pavarësisht kush ka bërë cdoganimin. Edhe në rastin më të keq, të keqkuptimit dhe keqzbatimit të ligjit nga ana juaj, sërish shoqëria jonë është në përmbushje të këtij kriteri pasi sic e thamë më sipër, kemi paraqitur edhe asfaltoshtruesen tjetër më shumë.

3.Përsa i përket pretendimit se: Kontrata e shitjes për eskavatorin me zinxhir nuk është lidhur përpara noterit sqarojmë se në përmbushje të këtij kriteri nga ana jonë nuk janë paraqitur dy, por tri copë mjete eskavatorë. Referuar dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar në këtë procedurë tenderimi 2 eskavatorë me zinxhir, dhe ndërkohë KVO pretendon se një nga eskavatorët e paraqitur nga shoqëria jonë, kontratën e shitjes së eskavatorit nuk e ka të nënshkruar para noterit. Por për plotësimin e këtij kriteri shoqëria jonë ka paraqitur tre eskavatorë dhe konkretisht Eskavatorin Liheberr R904 për të cilin KVO e paraqet si arsye për skualifikim, eskavatorin Ssmitoma S160 U- ë ME NR. Shasie 160 FU-5697 dhe Eskavatorin Volvo Telaio me nr. Shasie C012770. Edhe në rastin më të keq të keqzbatimit të ligjit nga ana juaj, sërish shoqëria jonë është në përmbushje të këtij kriteri pasi sic argumentuam më sipër, kemi paraqitur edhe eskavator tjetër më shumë.

4.Përsa i përket pretendimit se: minieskavatorin nuk përcaktohet në urdhër clirimin doganor se shitësi është importuesi i eskavatorit si dhe nuk ka vërtetim zhdoganimi. Nga ana jonë është paraqitur kontrata e blerjes, fatura tatimore dhe cdo document shoqërues sic është kërkuar në DST. Disponimin e mjetit nga ana e shitësit e ka vërtetuar noteri, bazuar në legjislacionin në fuqi, për të cilën ka përpiluar dhe kontratën përkatëse. [...].”.

III.4.9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, lidhur me arsyet e mësipërme të skualifikimit, rezulton se Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur:

- Shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”;
- Kamion me targë AA711HJ [...]
- Kamion me targë tërheqëse AA391 FB [...], targë rimorkio ABR 621.
- Gjysëm rimorkio ACR237
- Kamion me targë AA798 CP [...]
- Kamion me targë AA586 IC [...]
- Asfaltoshtruese Bitelli SPA BB 650
- Asfaltoshtruese me zinxhir
- Eskavator SSUMITOMO S160
- Eskavator Volvo EC 140
- Eskavator Liheberr R 904
- Minieskavator Volvo Telaio

Për mjetin me targë AA711HJ është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Certifikatë pronësie e mjetit për “Sireta 2F” sh.p.k
- Leje qarkullimi e mjetit
- Foto
- Taksa vjetore
- Çertifikaten e kontrollit teknik;

- Siguracionin e mjetit,
- Certifikate “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.

Për mjetin me targë *AA391 FB* është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Leje qarkullimi e mjetit terheqës
- Foto
- Taksa vjetore
- Çertifikaten e kontrollit teknik;
- Siguracionin e mjetit,
- Certifikate “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.

Për mjetin me targë rimorkio *ABR 621* është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Certifikatë pronësie e mjetit për “Sireta 2F” sh.p.k
- Leje qarkullimi e mjetit
- Foto
- Taksa vjetore
- Çertifikaten e kontrollit teknik;
- Siguracionin e mjetit,
- Certifikate “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.

Për mjetin gjysëm rimorkio me targë *ACR237* është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Certifikatë pronësie e mjetit për “Sireta 2F” sh.p.k
- Leje qarkullimi e mjetit
- Foto
- Taksa vjetore
- Çertifikaten e kontrollit teknik;
- Siguracionin e mjetit,
- Certifikate “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.

Për mjetin Kamion me targë *AA798 CP* është paraqitur dokumentacioni:

- Certifikatë pronësie e mjetit për “Sireta 2F” sh.p.k
- Leje qarkullimi e mjetit
- Foto
- Taksa vjetore
- Çertifikaten e kontrollit teknik;
- Siguracionin e mjetit,
- Certifikate “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.

Për mjetin Kamion me targë *AA586* është paraqitur dokumentacioni:

- Certifikatë pronësie e mjetit për “Sireta 2F” sh.p.k
- Leje qarkullimi e mjetit
- Foto
- Taksa vjetore
- Çertifikaten e kontrollit teknik;
- Siguracionin e mjetit,

- Certificate “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit.

Për mjetin Asfaltoshtruese Bitelli SPA BB 650 është paraqitur dokumentacioni:

- Urdhër clirimi lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.
- Transaksioni Bankar
- Faturë cdoganimi për “Sireta 2F” sh.p.k
- Foto

Për mjetin Asfaltoshtruese me zinxhir është paraqitur dokumentacioni:

- Faturë tatimore me blerës “Sireta 2F” sh.p.k
- Faturë cdoganimi
- Foto

Për mjetin Eskavator SSUMITOMO S160 është paraqitur dokumentacioni:

- Foto
- Kontratë shitlerje autormjeti me blerës “Sireta 2F” sh.p.k
- Vërtetim zhdoganimi për subjektin shitës
- Urdhër clirimi nga Dogana Durrës
- Transaksion bankar
- Fatura cdoganimi

Për mjetin Eskavator tipi Volvo EC 140 është paraqitur dokumentacioni:

- Foto
- Fatura cdoganimi për “Sireta 2F” sh.p.k
- Urdhër clirimi
- Transaksion bankar

Për mjetin Eskavator tipi Lihebert është paraqitur dokumentacioni:

- Foto
- Kontratë shitlerje autormjeti me blerës “Sireta 2F” sh.p.k
- Faturë tatimore me blerës “Sireta 2F” sh.p.k
- Faturë cdoganimi
- Urdhër clirimi
- Transaksion bankar

Për mjetin Minieskavator Volvo Telaio është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Foto
- Kontratë shitlerje autormjeti me blerës “Sireta 2F” sh.p.k
- Urdhër clirimi
- Transaksion bankar
- Faturë cdoganimi
- Faturë tatimore me blerës “Sireta 2F” sh.p.k

III.4.10. Lidhur me argumentin e KVO-se se “Mjeti AA391FB nuk ka të percaktuar kapacitetin në lejen e qarkullimit si dhe nuk është paraqitur certificate pronësie”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik ankimes është paraqitur dokumentacion i plotë që vërteton disponimin nga ana e tij të dy mjeteve kamion me kapacitet mbajtës nga 10-20 ton dhe

konkretisht automjetet me targë AA 711HJ dhe automneti me targë AA 586 IC. Përsa i përket kërkesës së autoritetit kontraktor për 1 kamion me kapacitet mbajtës 5-10 ton ankimuesi ka paraqitur në ofertë dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor për kamionin me targë AA 798 CP, ndërsa për kërkesën e AK-së për rimorkiator, shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion të plotë për mjetin ABR621 dhe ACR 237.

Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se argumenti i dhënë nga KVO si më sipër cituar, nuk qëndron, pasi ankimuesi ka dorëzuar në ofertë dokumentacion për mjete kamion dhe rimorkiator në një numër më të madh se ai i kërkuar nga autoriteti kontraktor, ndaj dhe konstatimi i bërë nga KVO-ja për mjetin AA391FB nuk ndikon dhe nuk ka asnjë efekt mbi kapacitetet e këtij subjekti. Konkretisht nga ana e tij plotësohet kërkesa për dy kamionë me kapacitet mbajtës nga 10-20 ton nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar për automjetet me targë AA 711HJ dhe me targë AA 586 IC ku është paraqitur Certifikatë pronësie për “Sireta 2F” sh.p.k, Leje qarkullimi, Foto, Taksa vjetore, Çertifikaten e kontrollit teknik, Siguracionin e mjetit, Certifikate “Për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit për secilin prej tyre.

Gjithashtu plotësohet edhe kërkesa për një kamion me kapacitet mbajtës 5-10 ton nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur për kamionin me targë AA 798 CP, dhe kërkesa për një rimorkiator, plotësohet nga dokumentacioni i paraqitur për mjetin ABR621 dhe ACR 237, si më sipër cituar.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4.11. Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se *per asfaltoshtruesen me zinxhir, urdheri i çlirimit doganore eshte fotokopje + fatura tatimore e leshuar, nuk eshte leshuar nga subjekti importues*, rezulton se në plotësim të kërkesës për një asfaltoshtruese, shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion për dy mjete; Asfaltoshtruese Bitelli SPA BB 650 dhe Asfaltoshtruese me zinxhir. Edhe në supozimin se *asfaltoshtruesja me zinxhir nuk plotëson kërkesat e AK-së*, shoqëria ankimuese ka paraqitur për mjetin Asfaltoshtruese Bitelli SPA BB 650 Foto, Faturë cdoganimi, Urdhër çlirimi, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Transaksioni Bankar, Faturë cdoganimi për “Sireta 2F” sh.p.k, të gjitha në emër të shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k, duke plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktor për asfaltoshtruese.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4.12. Lidhur me argumentin e autoritetit kontraktor se *Kontrata e shitjes per eskavatorin me zinxhir nuk eshte lidhur perpara noterit*, rezulton se në dokumentat e tenderit është kërkuar dëshmi për 2 eskavator me zinxhir. Nga ana e shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k konstatohet se është paraqitur dokumentacion për 3 eskavatorë me zinxhir, vërtetuar me foto të mjetit, Kontratë shitlerje automjeti me blerës “Sireta 2F” sh.p.k, lidhur para noterit; Vërtetim zhdoganimi për subjektin shitës; Urdhër çlirimi nga Dogana Durrës; Transaksion bankar; Fatura cdoganimi për mjetin Eskavator SSUMITOMO S160. Për mjetin Eskavator tipi Volvo EC 140 është paraqitur Foto, Fatura cdoganimi për “Sireta 2F” sh.p.k, Urdhër çlirimi, Transaksion bankar dhe për mjetin Eskavator tipi Lihebert është paraqitur Foto, Kontratë shitlerje automjeti me blerës “Sireta 2F” sh.p.k, Faturë tatimore me blerës “Sireta 2F” sh.p.k; Faturë cdoganimi; Urdhër çlirimi dhe Transaksion bankar. Konstatimi i AK se *Kontrata e shitjes per eskavatorin me zinxhir nuk eshte lidhur perpara noterit*, nuk qëndon pasi ankimuesi ka paraqitur për mjetin Eskavator tipi Lihebert

edhe faturë tatimore shitje nr. 40, datë 27.12.2016 me shitës shoqërinë “Eurotracks” sh.p.k dhe blerës “Sireta 2F” sh.p.k, në përputhje me kërkesën e AK, përcaktuar në dokumentat e tenderit, duke përmbushur dhe tejkaluar kriterin për eskavator me zinxhir.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.4.13. Lidhur me argumentin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave se *per minieskavatorin nuk percaktohet ne urdher çlirimin doganore se shitesi eshte importuesi i eskavatorit si dhe nuk ka vertetim zhdoganimi*, rezulton se në dokumenat e tenderit është kërkuar që ofertuesit të vërtetojnë me dhëshmi për disponimin e një minieskavatori, nëpërmjet paraqitjes së akteve të cdoganimit ose fatura tatimore të bjerjes.

Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet 2. *Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k ka paraqitur dokumentacion si vijon: Foto; Kontratë shitlerje automjeti Nr. 11480 Rep, Nr.1070 Kol, lidhur para noterit me blerës “Sireta 2F” sh.p.k dhe shitës z.Rr.Elezi; Urdhër çlirimi; Transaksion bankar; Fatura cdoganimi si dhe Faturë tatimore nr. 04, datë 10.11.2008 me blerës “Sireta 2F” sh.p.k dhe shitës z.Rr.Elezi.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për një minieskavator, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij është në përputhje me kushtet e paracaktuara në dokumentat e tenderit, dhe nenin 46 të LPP-së. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se, autoritet kontraktore duhet të përcaktojnë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kriterëve, si dhe nuk duhet të përdorin kriterë që nuk janë të përcaktuara në dokumentat e tenderit të procedurës përkatëse të prokurimit.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k për për operatorët ekonomikë “Arb&Trans-2010” sh.p.k, “Kthella” sh.p.k dhe “Liqeni VII” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorëve për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët ekonomikë të renditur me vlerë ekonomike më të lartë se vlera e ofertës së tij ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k për për operatorët ekonomikë “Arb&Trans-2010” sh.p.k, “Kthella” sh.p.k dhe “Liqeni VII” sh.p.k, nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-09523-02-20-2019, me objekt: “*Ndërtim rruga Skënderbeu+Shebeniku*”, me fond limit 59.286.710 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 02.04.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sireta 2F” shpk
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 855 Protokolli

Datë 14.05.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha